



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimar - Pranimja më: Data 18-03-2026			
Nr. Formuarit Org. Breg	Nr. Formuarit Org. Breg	Nr. Formuarit Org. Breg	Vlera Vrednost
01-	016	/01	351



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Komuna e Vitisë, duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 17, pika 1.2 dhe nenin 22, pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe në nenin 14, nënparagrafin 1.5 të Rregullores Nr. 02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës, Komisioni i themeluar me vendim të Kuvendit Komunal të Vitisë, Vendim për themelimin e Komisionit për përgatitjen e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të Komunës së Vitisë, me nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, si dhe me vendimin nr. 01-110/05-155, të datës 02.02.2026, organizon këtë

NJOFTIM për konsultim publik

Lidhur me organizimin e konsultimit publik me qytetarët për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë, me nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011. Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga data **18.03.2026 deri më datën 16.04.2026**. Debat i publik me qytetarët do të mbahet më datën **20.04.2026**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (Shtëpia e Kulturës), në orën 10:00.

Propozimet, sugjerimet për plotësim apo ndryshim, si dhe vërejtjet eventuale, mund të paraqiten në ditën e mbajtjes së debatit publik. Gjithashtu, ato mund të dorëzohen me shkrim gjatë periudhës së konsultimit publik në Zyrën e Sekretarisë së Kuvendit Komunal të Komunës së Vitisë (ndërtesa e Kryetarit, zyra nr. 1), si dhe në formë elektronike në adresën elektronike: Fatlum.Demiri@rks-gov.net.

Dokumenti është i publikuar në faqen zyrtare të komunës: <https://viti.rks-gov.net/>.

Bashkëngjitur me këtë njoftim gjenden rekomandimet e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

Viti, më 17.03.2026

Kryesues i komisionit

Fatlum Demiri





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

DRAFTDOKUMENTI

**për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr.
01-013/491, të datës 21.04.2011**

Draftdokumenti

për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011

Neni 1

Neni 10, paragrafi 10.2 të statutit bazë, shkronja f, ndryshohet dhe duhet të jetë me këtë përmbajtje:
f – Ka cilësinë e punëdhënësit, punëson kategoritë e zyrtarëve publik dhe të emëruarit politik.

Neni 2

Neni 13, paragrafi 13.3 të statutit bazë, riformulohet si në vijim:

13.3 Kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillave lokalë nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.

Neni 3

Neni 28, paragrafët 28.2 dhe 28.3 të statutit bazë, riformulohen si në vijim:

28.2 Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 28, paragrafi 28.3 të statutit bazë riformulohet si në vijim:

28.3 Nëse kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafit 28.2 të këtij neni, mbledhja inauguruese thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur ta thërrasë mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Neni 30, të statutit bazë, te paragrafi 30.3 ndryshohet dhe i shtohet shkronja d:
d – seanca urgjente.

Neni 5

Neni 31, të statutit bazë, paragrafi 31.1 riformulohet dhe duhet të ketë këtë përmbajtje:

31.1 Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal thirret për çështje me rëndësi për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Neni 6

Neni 31, të statutit bazë, paragrafi 31.2 riformulohet dhe duhet të ketë këtë përmbajtje:

31.2 Seancën e jashtëzakonshme e thërret kryesuesi i Kuvendit të Komunës pas kërkesës me shkrim nga kryetari i Komunës apo 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 7

Neni 32, të statutit bazë ndryshohet dhe i shtohet neni 32.a:

32.a pika 1 Seanca urgjente thirret në raste të fatkeqësive natyrore (Vis Maioris) dhe rrethanave të tjera urgjente në komunë; kryesuesi i Kuvendit dhe kryetari i komunës kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente.

32.a pika 2 Procedurat për thirrjen e mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastet e thirrjeve të mbledhjeve të tjera.

Neni 8

Neni 46 i statutit bazë, paragrafi 46.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

46.1 Kuvendi i Komunës së Vitisë, për çështje të caktuara nga fusha e përgjegjësisë dhe kompetencave të tij dhe sipas propozimit të kryetarit të komunës, themelon komitete konsultative. Anëtarët e komiteteve konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse. Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve konsultative. Mandati i anëtarëve të komiteteve konsultative është katër (4) vjeçar, nga themelimi i komitetit.

Neni 9

Neni 47, paragrafi 47.2, shkronjat e dhe h të statutit bazë ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

e) Komiteti për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

h) Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Neni 10

Neni 50, paragrafi 50.1, shkronjat h dhe s ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

50.1 shkronja h – Vendos për formimin dhe strukturimin e administratës komunale në përputhje me statutin në fuqi dhe rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

s – fshihet nga statuti bazë dhe riformulohet me këtë përmbajtje:

s – I propozon Kuvendit të Komunës miratimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 11

Neni 50, paragrafi 50.1, ndryshohet dhe i shtohet shkronja v) me këtë përmbajtje:

v – Themelon Komitetin për Auditim, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazë, nënparagrafët 2, 4, 9 ndryshohen dhe i njëjti ka këtë përmbajtje:

2.a Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe

b Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazë, nënparagrafi 4 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:

4.a Drejtoria për Shërbime Publike dhe

b Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazë, nënparagrafi 9 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:

9 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Neni 13

Neni 56, paragrafi 56.4 të statutit bazë riformulohet dhe duhet të ketë këtë përmbajtje:

56.4 Organizimi i drejtorive komunale dhe strukturimi i brendshëm i tyre rregullohet në bazë të rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Vitisë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës, e cila rregullore përcakton kushtet dhe standardet në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 14

Neni 58 të statutit bazë fshihet.

Neni 15

Neni 62, paragrafi 62.1 të statutit bazë, togfjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim", riformulohet: "Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa".

Neni 16

Neni 64, paragrafi 64.1 të statutit bazë, togfjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim" riformulohet: "Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa".

Neni 17

Neni 65, paragrafi 65.1 të statutit bazë: togfjalëshi "Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149", i paraparë në të gjitha nenet e statutit bazë, ndryshohet dhe bëhet: "Ligji për Zyrtarët Publikë", në fuqi.

Neni 18

Neni 66, paragrafi 66.1, shkronja f të statutit bazë ndryshohet dhe i njëjti ka këtë përmbajtje: f Kategoritë e zyrtarëve publikë sipas nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Zyrtarët Publikë në fuqi.

Neni 19

Neni 68, paragrafi 68.1 të statutit bazë ndryshohet dhe i njëjti ka këtë përmbajtje:
68.1 Me qëllim të planifikimit, administrimit dhe punësimit të zyrtarëve publikë, në përputhje me nenin 14 të Ligjit për Zyrtarët Publikë në fuqi, Komuna e Vitisë themelon Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Neni 20

Neni 69, paragrafi 69.1 dhe në nenet tjera të statutit bazë ku ceket: "Njësia e personelit dhe Udhëheqësi i personelit", ndryshohet me këtë përmbajtje: "Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore".

Neni 21

Neni 73, paragrafët 73.1 dhe 73.2 të statutit bazë ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:
73.1 Në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi në komunë, Zyra e Kryetarit të Komunës organizohet në këto njësi dhe sektorë:

- 1 Kabineti i kryetarit
- 2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- 3 Njësia për Prokurim
- 4 Njësia për Auditim të Brendshëm
- 5 Sektori Ligjor dhe Përfaqësimi (Avokati Komunal)
- 6 Sektori për Punë të Kuvendit Komunal
- 7 Sektori për Menaxhimin e Kontratave, Zhvillimin e Projekteve dhe Infrastrukturë
- 8 Sektori për Komunitete, Kthim dhe Riatdhesim
- 9 Sektori për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim
- 10 Sektori për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Integrim Evropian

11 Certifikuesi i Buxhetit

73.2 Fushëveprimi, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive apo sektorëve të cekura më lart caktohen me legjislacionin në fuqi si dhe me rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

73.3 Njësitë dhe sektorët e cekura më lart për punën e tyre i përgjigjen drejtpërdrejt kryetarit të komunës.

Neni 22

Nenet 74 dhe 75 të statutit bazë fshihen.

Neni 23

Pas miratimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë, pushojnë së vlejture dhe shfuqizohen dispozitat e ndryshuara dhe të plotësuara të Statutit Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.

Neni 24

Ndryshimet dhe plotësimet në statut hyjnë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Vitisë.